



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.05.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen: Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 341, 342, 343, 344, 345, 346 e 347 datë 15.5.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në qarkun Tiranë për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” dhe “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarqet Korçë e Tiranë për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” si dhe “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë qarqet Elbasan, Lezhë, Korçë, e Tiranë për plotësimin vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve respektivisht: z. Halit Valteri, z. Vasil Sterjovski, z. Edmond Stojku, z. Florenc Spaho, z. Ardit Konomi, znj. Ardiana Jaku, z. Eljo Hysko.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Musa Ulqini, Myslym Murrizi, Alban Zeneli, Nimet Musaj, Aurora Mara

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Klotilda Bushka, Ulsi Manja

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëemërore të Partisë Demokratike në qarkun Tiranë, të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarqet Korçë dhe Tiranë dhe të Partisë Socialiste në qarqet Tiranë, Elbasan, Korçë dhe Lezhë.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Kandidatët që kanë fituar mandatin e deputetit janë konkretisht:

- Z. Halit Valteri, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 341, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Tiranë.

- Z. Vasil Sterjovski, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 342, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Korçë.

- Z. Edmond Stojku, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 343, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Tiranë.

- Z. Florenc Spaho, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 344, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Socialiste, Qarku Elbasan.

- Z. Ardit Konomi, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 345, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Socialiste, Qarku Korçë.

- Znj. Ardiana Jaku, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 346, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Socialiste, Qarku Lezhë.

- Z. Eljo Hysko, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 347, datë 15.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Socialiste, Qarku Tiranë.

Janë njoftuar kandidatët respektivë që të jenë të pranishëm në këtë mbledhje Këshilli. Arsyeja e thirrjes është pasi na është krijuar një precedent dhe sipas Rregullore së Kuvendit të shpreheni nëse e pranoni të bëni betimin në seancën pasardhëse në zbatim të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

Gramoz Ruçi – Zoti Halit pranoni ta bëni betimin në seancë?

Halit Valteri – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zoti Vasil pranoni ta bëni betimin në seancë?

Vasil Sterjovski – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zoti Edmond pranoni ta bëni betimin në seancë?

Edmond Stojku – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zoti Florenc pranoni ta bëni betimin në seancë?

Florenc Spaho – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zoti Ardit pranoni ta bëni betimin në seancë?

Ardit Konomi – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zonja Ardiana pranoni ta bëni betimin në seancë?

Ardiana Jaku – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zoti Eljo pranoni ta bëni betimin në seancë?

Eljo Hysko – Po, pranoj

Gramoz Ruçi – Ju faleminderit! Kaq ishte.

Kjo është një procedurë e zakonshme për të mos ndodhur ndonjë precedent, është një kërkesë e Rregullores para se të kalojmë në seancën plenare që ju do të bëni betimin, prandaj jeni të ftuar që të uleni në sallën e Kuvendit që fillon në orën 10:00, pasi pika e parë e rendit të ditës do të jetë betimi që ju do të bëni në Kuvend që të filloni ushtrimin e mandatit të deputetit. Faleminderit dhe suksese paraprakisht!

(largohen kandidatët për deputetë...vijon mbledhja me anëtarët e Këshillit)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet e mësipërme, nr. 341, 342, 343, 344, 345, 346 dhe 347 i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatëve vijues të listave respektive. Vendimet i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri? Është bërë një përmbledhje e raportit apo do paraqiten 2 raporte?

Mimoza Pano - Dy raporte janë përgatitur për deputetët në seancë plenare, referuar dy mbledhjeve që ka zhvilluar Këshilli i Mandateve zoti kryetar. Për raportin e përmbledhur që do të lexohet në seancë plenare të gjithë e kemi përfshirë në një të vetëm.

Gramoz Ruçi – Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. Musa Ulqini ta lexojë në seancë raportin e përmbledhur, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit, që i paraqitet Kuvendit në seancë.

Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET